



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

# **Raport<sup>1</sup>**

## **mbi ecurinë e treguesve që do të monitorojë Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të deeuroizimit**

### **Shkurt 2018**

---

<sup>1</sup> Ky Raport del në zbatim të parashikimeve të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” nënshkruar më 18.04.2017, dhe publikuar në adresën e internetit:

[https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi\\_gksf\\_9384\\_1.pdf](https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf)

## **Përmbajtje**

I	<a href="#">Hyrje</a> .....	3
II	<a href="#">Ecuria e treguesve</a> .....	5
III	<a href="#">Konkluzion</a> .....	14
	<a href="#">Aneksi I: Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të de-euroizimit</a> .....	16

## I Hyrje

Dukuria e përdorimit të monedhave të huaja në sistemin financiar (më tej “euroizim”<sup>2</sup>), në sektorin bankar dhe në ekonominë shqiptare është e hershme. Mes disa faktorëve, kjo dukuri reflekton edhe nivelin e lartë të tregtisë dhe të shkëmbimeve financiare me vendet e Eurozonës, në mënyrë të ngjashme me vende të tjera të rajonit<sup>3</sup>. Niveli i lartë i përdorimit të monedhave të huaja në sektorin bankar, shoqërohet me efekte negative tek kanalet e transmetimit të politikës monetare dhe rrit rreziqet për stabilitetin financiar. Në këto kushte dhe në funksion të zbatimit me efektivitet të këtyre politikave, është e nevojshme të pakësohen këto ndikime të padëshiruara, duke nxitur përdorimin më të lartë të monedhës vendase<sup>4</sup> në transaksionet financiare dhe në ekonominë reale.

Kjo mund të realizohet përmes masave të ndryshme që mund të identifikohen nga autoritetet, në bashkëpunim me industrinë financiare dhe aktorë të tjerë të tregut. Për shkak të faktorëve përcaktues dhe ndikimeve strukturore që kanë ardhur nga përdorimi për një kohë të gjatë i monedhave të huaja nga subjektet ekonomike, ulja në zero e nivelit të përdorimit të monedhave të huaja në sistemin financiar dhe në ekonominë reale është një objektiv jorealit dhe madje i dëmshëm ekonomikisht. Ndaj masat që mund të merren në këtë proces, duhet të synojnë uljen e niveleve aktuale të përdorimit të monedhave të huaja në sistemin financiar dhe më gjerë, drejt një niveli ku nevojat e subjekteve ekonomike konsiderojnë në mënyrë më të drejtë ekspozimet ndaj rreziqeve financiare dhe nuk bëhen pengesë për zbatimin me efektivitet të politikave ekonomike<sup>5</sup>.

Duke qenë se niveli i euroizimit në sistemin financiar reflekton përgjithësisht shkallën e përdorimit të monedhave të huaja në ekonominë reale, procesi i deeuroizimit duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe veprimet e ndërmarra në këtë proces të jenë të harmonizuara. Për këtë qëllim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi në muajin prill të vitit 2017, ku angazhohen të ndërmarrin veprime në fushat e tyre të kompetencës. Në këtë

---

<sup>2</sup> Vite më parë, kjo dukuri njihet kryesisht me termin “dollarizim” duke reflektuar shkallën e lartë të përdorimit të dollarit amerikan në ekonominë e vendeve të ndryshme të botës, veçanërisht në Amerikën Latine dhe në Azi. Më vonë, me daljen e monedhës evropiane, euro, dhe rritjen e shkallës së përdorimit të saj, veçanërisht në vendet pranë Eurozonës, kjo dukuri njihet edhe me termin “euroizim”.

<sup>3</sup> Është i mirënjohur një vrojtje i rregullt që kryhet për vendet e rajonit nga Banka Kombëtare e Austrisë, i cili jep informacion të vlefshëm mbi prirjet e përdorimit të monedhave të huaja në këto vende dhe faktorët përkatës. Rezultatet e këtij vrojtimi publikohen në adresën e internetit: <https://www.oenb.at/en/Monetary-Policy/Surveys/OeNB-Euro-Survey.html>

<sup>4</sup> “Rritja e përdorimit të monedhës vendase” apo “ulja e përdorimit të monedhave të huaja” përfaqësojnë të njëjtin synim/rrijedhojë të përdorimit të masave që synojnë uljen e niveleve të euroizimit. Në tekstin e këtij raporti, këta togfjalësh mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit, duke pasur të njëjtin kuptim.

<sup>5</sup> Një studim i Fondit Monetar Ndërkombëtar, gjen se vendet me ekonomi të vogël dhe të hapur, që ndërveprojnë ngushtë me zona ekonomike të mëdha (siç është rasti i Shqipërisë me Eurozonën dhe Bashkimin Evropian), tentojnë të kenë nivele më të larta të euroizimit (i identifikuar si raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave) krahasuar me vende të tjera. Në këtë rast, vlerësohet shmangia e niveleve aktuale të euroizimit, prej atij “të synuar”, ku ky i fundit përcaktohet në mënyrë empirike nga analiza e një paneli vendesh. Për Shqipërinë, kjo shmangie rezulton më e lartë se 10 pikë përqindje, nëse konsiderohet struktura e ekonomisë dhe performanca e mirë makroekonomike.

kuadër, për sektorin bankar, Banka e Shqipërisë ka identifikuar, ka konsultuar me bankat dhe miratoi së fundi<sup>6</sup> disa masa, që përfshijnë:

- *ndryshimin e normës së rezervës së detyrueshme.* Më konkretisht, përcaktohet rritja e normës së rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë në nivelin 12.5% (ishte 10%), dhe ulja e saj për detyrimet në lekë në nivelin 7.5% (ishte 10%). Për bankat ku detyrimet në valutë zënë më shumë se 50% të detyrimeve totale, vetëm për vlerën e ndryshimit pozitiv, norma e rezervës së detyrueshme në valutë rritet në 20%;
- *rritjen e kërkesës minimale rregullative për vlerën e aktiveve likuide në valutë.* Më konkretisht, për aktivet likuide në valutë do të kërkohej që të jenë jo më pak se 20% e detyrimeve afatshkurtra në valutë (ishte 15%), ndërsa për aktivet likuide në lekë, niveli i raportit do të ruhet në 15%;
- *rritjen e ndërgjegjësimit të huamarrësve për rreziqet që shoqërojnë huamarrjen në valutë.* Më konkretisht, bankave do t'iu kërkohej që: t'iu propozojnë huamarrësit një kredi alternative në lekë; ta pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rastin e nënçmimit të lekut (me vlera të përcaktuara); të ofrojnë opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e kursit të këmbimit për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet që janë dakordësuar nga banka dhe huamarrësi.

Banka e Shqipërisë ka synuar të kufizojë rreziqet që shoqërojnë veprimtarinë në valutë të sektorit bankar dhe të klientëve të tij edhe më parë<sup>7</sup>. Por masat e përmendura më sipër reflektojnë kontributin e Bankës së Shqipërisë në kuadër të një procesi më të strukturuar dhe më të qëndrueshëm. Këto masa mund të ndryshojnë dhe të pasohen nga të tjera në të ardhmen.

Ky raport nuk synon të analizojë në thellësi shkaqet dhe pasojat e euroizimit në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare, por vetëm të identifikojë disa tregues të sektorit bankar dhe më gjerë (ku valuta zë peshë të rëndësishme), të cilët do të monitorohen në vazhdimësi për të vlerësuar ndikimin e masave të marra në kuadër të procesit të deeuroizimit. Ndër këta tregues, që fokusohen tek veprimtaria në valutë, në këtë raport janë përfshirë: depozitat e sektorit privat, kredia për sektorin privat, ecuria e borxhit publik dhe kursi i këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore. Në raport, bëhet një paraqitje e ecurisë së treguesve, në vitet e fundit, duke dalluar prirjen përkatëse. Lista e treguesve në këtë numër të raportit mund të plotësohet me të tjerë në të ardhmen.

Duhet pasur parasysh që ecuria e treguesve financiarë dhe përdorimi i valutës, përgjithësisht ndikohen edhe nga faza e ciklit ekonomik apo financiar. Kështu, në kushtet e ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe rënies së presioneve inflacioniste, pas vitit 2009,

---

<sup>6</sup> Vendime të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të datës 7 shkurt 2018.

<sup>7</sup> Shiko Aneksin e Raportit.

u bë i nevojshëm lehtësimi i ndjeshëm i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë (ulja e normës bazë të interesit për lekun). Kjo ndikoi në ngushtimin e diferencës midis normave të kthimit nga investimet në instrumente financiare në lekë (depozita, tituj) dhe në valutë, dhe në preferencën e publikut për këto instrumente. Nga ana tjetër, normat më të ulëta të interesit e kanë bërë më konkurruese kredinë në lek, duke sjellë rritjen e peshës së saj kundrejt kredisë në valutë. Paralelisht, një faktor tjetër që mund të ndikojë në normën e kthimit nga investimi në instrumentet financiare, është edhe kursi i këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore. Nëse kemi forcim të kursit të këmbimit të lekut, norma reale e kthimit nga investimi në instrumentet financiare në lekë (duke supozuar faktorë të tjerë të pandryshuar) përmirësohet, duke ndikuar kështu në rritjen e preferencës së investitorëve për mbajtjen e këtyre instrumenteve.

Krahas elementeve ciklike, ecuria e treguesve ndikohet edhe nga ndërveprimi midis tyre. Konkretisht, një rritje e mundshme e depozitave në valutë të sektorit bankar, në kushtet e përmirësimit të kërkesës për kredi, mund të transmetohet në drejtim të rigjallërimit të kreditimit në valutë, veçanërisht në rastin e perceptimeve të gabuara mbi rrezikun e kursit të këmbimit që mbështeten mbi luhatshmërinë e ulët të tij në periudhat e fundit. Prosesi hyn në një rreth vicioz dhe përforcues, në kushtet kur kredia në valutë rrit më tej depozitat në valutë. Gjithashtu, rritja e huamarrjes (borxhit) publike në valutë, shoqërohet me hyrjen e valutës në tregun e brendshëm, dhe kanalizimin e saj final në depozita pranë sektorit bankar. Përsëri, kjo nxit një rigjallërim të veprimtarisë së përgjithshme në valutë, duke ashpërsuar rreziqet që lidhen me këtë dukuri.

Duhet pasur parasysh që procesi i deeuroizimit konkurron me objektiva të tjerë të agjentëve ekonomikë, privatë dhe publikë. Në raste të caktuara, vendimmarrja e tyre mund t'i japë përparësi një objektivi tjetër, i cili mund të duket në konflikt me procesin e deeuroizimit. Në këtë rast, më e rëndësishme është që vendimmarrja të jetë mbështetur në një analizë të përshtatshme. Më konkretisht, zgjedhja e përparësive mes objektivave të ndryshëm, nuk duhet të vlerësojë vetëm përfitimet afatshkurtra, shpesh të fokusuara në drejtime specifike që janë të rëndësishme vetëm për subjektet ekonomike, por të përfshijë në analizë edhe ndikimin që procesi (i munguar) i deeuroizimit ka mbi qëndrueshmërinë financiare të tyre dhe të gjithë ekonomisë, në afat më të gjatë.


## **II Ecuria e treguesve**

Në këtë numër të parë të raportit, do të bëhet një përshkrim i ecurisë së depozitave të sektorit bankar, të kredive të sektorit bankar, strukturës së borxhit publik dhe kursit të këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore.

Për **DEPOZITAT**, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2017, rezulton që:

Në *stokun e depozitave* pranë sektorit bankar, depozitat në valutë të sektorit privat<sup>8</sup> shënuan 53.5% të depozitave të përgjithshme. Gjatë pesë viteve të fundit, vlera e depozitave në valutë është rritur me 25%, ndërsa vlera e depozitave në lekë u rrit me 8%.


**Grafik 1: Struktura e depozitave sipas monedhës**



Burimi: Banka e Shqipërisë (BSH).

Në strukturën e përgjithshme të depozitave të sektorit privat, depozitat e individëve mbizotërojnë duke zënë rreth 87% të vlerës. Duke mbajtur në konsideratë këtë përbërje, në vijim bëhet një ndarje sipas monedhës dhe sipas afatit të maturimit të depozitave. Sipas Grafikut 2, krahasuar me fundin e vitit 2015, depozitat e biznesit janë rritur me 24%, ndërkohë që depozitat e individëve kanë shënuar rritje me vetëm 3%. Rritja për individët dhe për bizneset është ndikuar kryesisht nga depozitat në valutë pa afat, të cilat u rritën me 38% për individët dhe 39% për bizneset. Në rastin e depozitave të individëve, krahasuar me fundin e vitit 2015, vërehet rënie e depozitave me afat si për lekun ashtu edhe për valutën, me përkatësisht 8.2% dhe 6.9%.

**Grafik 2: Teprica e depozitave sipas monedhës dhe afatit**




Burimi: BSH.

<sup>8</sup> Sektori privat përbëhet nga depozitat për korporatat jofinanciare private (bizneset) dhe individët plus institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve (individët).

Sipas peshave, nga Grafiku 3 vërehet se për individët, depozitat në valutë zënë 50.6% të totalit, duke u rritur me 2 pikë përqindje në dy vitet e fundit. Për bizneset, vlera e depozitave në valutë zë një peshë më të lartë se tek individët, dhe ajo ka ardhur gjithashtu në rritje gjate dy viteve të fundit. Rritja e depozitave në valutë për individët dhe bizneset, ka qenë kryesisht në depozita pa afat. Kjo ecuri ka reflektuar strukturën e përgjithshme të maturimit të depozitave për bizneset ku rreth 84% e depozitave janë pa afat, por ka qenë e kundërt për individët ku depozitat pa afat zënë rreth 44% të totalit të depozitave të tyre.


**Grafik 3: Struktura e depozitave sipas monedhës dhe llojit për individët (në të majtë) dhe bizneset (në të djathtë)**



Burimi: BSH.

Për sa i takon shpërndarjes së depozitave sipas 12 qarqeve të vendit, qarku i Tiranës zotëron rreth 45% të totalit të depozitave të sektorit bankar. Ndërkohë, raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave sipas qarkut, është mbi 50% për 3 nga 12 qarqet e vendit: Vlora me 56.2%, Tirana me 56%, dhe Gjirokastra me 50.3%. Sipas afatit të maturimit, qarqet me raportin më të ulët të depozitave me afat ndaj totalit të depozitave të qarkut, janë: Kukësi me 34%, Tirana me 49.1%, dhe Dibra me 50.6%.

**Grafik 4: Depozitat në fund të tremujorit të tretë 2017 sipas qarqeve, monedhës dhe afatit të maturimit**




Burimi: BSH.

Sipas peshës, struktura e depozitave të individëve dhe bizneseve paraqitet më e balancuar për qarkun e Elbasanit, Shkodrës dhe Korçës, të cilat kanë dhe peshë më të madhe të

depozitave për individë në monedhën vendase dhe me afat. Për 11 nga 12 qarqet, depozitat në valutë me afat përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të depozitave në valutë. Për sa i përket depozitave të bizneseve, qarku i Tiranës, Dibrës dhe Vlorës paraqiten me nivelin më të lartë të depozitave në valutë. Në përgjithësi, pavarësisht monedhës, depozitat e bizneseve janë pa afat. Vetëm qarku i Gjirokastrës ka një nivel të lartë të depozitave të bizneseve në monedhën vendase dhe me afat. Në qarqet e Shkodrës, Dibrës, Gjirokastrës dhe Kukësit, depozitat me afat në valutë të bizneseve, mungojnë plotësisht.


**Grafik 5: Peshat e depozitave në fund të tremujorit të tretë 2017 sipas qarqeve, monedhës dhe llojit**



Burimi: BSH.

Tek **Depozitat e reja**, të vendosura gjatë periudhës tremujore, vërehet që ecuria dominohet nga depozitat në monedhën vendase. Depozitat pa afat në monedhën vendase përdoren më shumë si nga individët dhe bizneset për të kryer veprimtaritë e përditshme, për rrjedhojë zënë edhe peshën më të madhe. Megjithatë, në dy vitet e fundit ecuria e depozitave të reja në valutë ka qenë në rritje, ndërsa ajo e depozitave të reja në lekë ka ardhur në rënie.

**Grafik 6: Depozitat e reja, të ndara sipas monedhave**



Burimi: BSH.




Për **KREDITË**, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2017, rezulton që:

**Në stokun e kredive**, mbizotërojnë kreditë për ndërmarrjet (biznesin), ku pjesa më e madhe e tyre mbetet në valutë. Ndër to, ekspozimin më të madh ndaj rrezikut e kanë kreditë në valutë ku të ardhurat e subjektit huamarrës janë në lekë (kreditë e pambuluara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit), të cilat përbëjnë rreth 25% të portofolit të kredive për biznesin. Prirja për kredimarrje në valutë tek bizneset, vijon edhe tek kreditë më të reja, ndërkohë që për individët, kreditë e reja kanë qenë kryesisht në monedhën vendase.

Në tërësi, gjatë pesë viteve të fundit vërehet një prirje në rritje e peshës së kredive në monedhën vendase dhe rënie e peshës së kredisë në valutë. Kjo ecuri ka përkuar me ciklin lehtësues të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, i cili është shoqëruar me rënie e normës së interesit për kreditë në lekë dhe i ka bërë ato më konkurruese ndaj kredive në valutë. Paralelisht, është vërejtur një rënie e vlerës së kredive në valutë që janë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

**Grafik 7: Totali i kredisë për sektorin privat, në lekë dhe në valutë (e mbrojtur dhe e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit)**




Burimi: BSH.

Portofoli i kredisë dominohet nga kreditë dhënë biznesit, ndërkohë që portofoli i kredive për individë përbën më pak se 20% të kredive dhënë sektorit privat<sup>9</sup>. Për individët, kredia në lekë është rritur duke dhënë sinjale pozitive për sa i përket objektivit të deeuroizimit. Prania e valutës është më e theksuar në portofolin e kredive të biznesit, ku prirja rritëse e kreditimit në monedhën vendase ka qenë më e ngadaltë.

<sup>9</sup> Kreditë dhënë sektorit privat përbëhen nga kreditë për korporatat jofinanciare private (bizneset) dhe individët plus institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve (individët).


**Grafik 8: Teprica e kredisë, në lekë dhe në valutë (e mbrojtur dhe e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit)**



Burimi: BSH.

Si peshë, vërehet një prirje rritëse e kredisë në lekë, si tek portofoli i kredisë për individë ashtu edhe tek ai i kredisë për bizneset. Megjithë përmirësimin, pesha e kredisë në valutë, mbetet më e lartë tek portofoli i kredisë për biznese. Tek bizneset, rreth 25% e portofolit të kredive janë kredi në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Kjo kredi, përfaqëson rreth 73% të totalit të kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, dhënë nga sektori bankar. Kjo kategori e kredive në valutë konsiderohet me rrezikun më të lartë, pasi luhatjet e pafavorshme në kursin e këmbimit do të kishin efekte të menjëhershme në vlerën e këstit dhe të ekspozimit.


**Grafik 9: Struktura e portofolit të kredisë, e ndarë sipas kredive në lekë dhe në valutë (e mbrojtur dhe e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit)**



Burimi: BSH.

Përsa i takon shpërndarjes së kredive në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, si peshë e portofolit të kredive për klientët, vërehet një prirje në rënie e mesatares së sektorit. Megjithatë, ka ende banka të cilat janë relativisht më të ekspozuara ndaj klientëve të pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Për 12 nga 16 bankat e sistemit, të paktën një në katër kredi për biznesin (mbi 26%) janë kredi të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.


**Grafik 10: Shpërndarja e peshës së kredive në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive**



Burimi: BSH.

Tek **kreditë e reja**, gjatë periudhës së analizuar, kreditë për individë kanë shfaqur një prirje të qëndrueshme rritëse. Ndërsa, kreditë e reja për bizneset kanë shënuar luhajtje, ndikuar nga proceset e ciklit të biznesit, aktiviteti me jorezidentët dhe ristrukturimet e kredisë.


**Grafik 11: Kreditë e reja, të ndara sipas monedhave**



Burimi: BSH.

Tek individët, kreditë e reja janë kryesisht në monedhën vendase dhe pjesa e mbetur në valutë mbizotërohet nga kredia në euro. Tek bizneset, kredia e re në valutë mbetet kryesore, si në vlerë ashtu edhe në peshë, dhe mbizotërohet nga kredia në euro, shoqëruar nga një pjesë më e vogël në dollar amerikan.

**Grafik 12: Struktura e kredive të reja sipas monedhave**




Burimi: BSH.

Për **BORXHIN PUBLIK**, vërehet:

**Rritja e vlerës së borxhit publik në 4-5 vitet e fundit është ndikuar kryesisht nga rritja e vlerës së borxhit të jashtëm, në valutë.** Në fakt, gjatë periudhës së analizuar konstatohen dy ndryshime thelbësore në drejtim të borxhit publik: 1) rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet më të gjatë se 12 muaj; 2) rritje e peshës së detyrimeve në valutë të qeverisë shqiptare. Borxhi i brendshëm është kryesisht në lekë, ndërsa borxhi i jashtëm është në valuta të ndryshme, por kryesisht në euro.

Në borxhin e brendshëm, vërehet një zhvendosje graduale drejt titujve të borxhit me afat mbi pesë vjet. Ky është një zhvillim pozitiv që pakëson rrezikun e riinvestimit të borxhit dhe përmirëson karakteristikat e tregtimit të tij.

**Grafik 13: Ndryshimi në strukturën e borxhit të brendshëm sipas afatit të maturimit**




Burimi: Të dhëna nga faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, përpunuar nga BSH.

Rritja graduale e borxhit të jashtëm, në nivelin 49% të totalit të borxhit të Qeverisë, është kryer në funksion të optimizimit të kostove të borxhit (duke qenë se borxhi i huaj ofron mundësi financimi me terma jotregtarë dhe pjesërisht tregtarë) dhe të uljes së financimit


në tregun e brendshëm, duke kontribuar në rritjen e mundësive të kreditimit të sektorit privat nga ana e sektorit bankar.

**Grafik 14:** Ecuria e borxhit publik në lekë dhe valutë, si dhe pesha e borxhit publik në lekë ndaj totalit



Burimi: Të dhënat nga faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, përpunuar nga BSH.

**Grafik 15:** Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhave



Burimi: Ministria e Financave dhe e Ekonomisë


Gjatë dy viteve të fundit, niveli i borxhit në valutë ka qenë relativisht i qëndrueshëm. Aktualisht, ai është ndjeshëm nën limitin e përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (55% të totalit) dhe në përputhje me analizat e qëndrueshmërisë që kryen Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Përpjekjet për të kontrolluar nivelin e borxhit të jashtëm, ofrojnë një mbështetje më të mirë për procesin e deeuroizimit.

Për ecurinë e **KURSIT TË KËMBIMIT**, vërehet:

Gjatë viteve të fundit, monedha vendase ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme në këmbimin me dy valutat kryesore, euron dhe dollarin amerikan. Kundrejt euros, ecuria e

lekut ka treguar luhatshmëri të ulët dhe ka shfaqur një prirje të lehtë forcuese në vitet e fundit. Kundrejt dollarit amerikan, luhatshmëria ka qenë më e lartë, duke reflektuar përgjithësisht ecurinë e kursit të këmbimit të dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare të këmbimit.

**Grafik 16: Ecuria e kursit të këmbimit të Lekut ndaj dy valutave kryesore**



Burimi: BSH.

Stabiliteti makroekonomik shoqërohet zakonisht me qëndrueshmëri të kursit të këmbimit. Në përgjithësi dhe në afat të gjatë, kjo ecuri duhet të mbështesë besimin e publikut në monedhën kombëtare dhe të rrisë përdorimin e saj nga agjentët e ekonomisë. Nga ana tjetër, prirja afatgjatë nuk përjashton luhatshmërinë e kursit të këmbimit në periudha të caktuara, duke ndikuar në vlerën e kursimeve dhe të huamarrjes në valutë. Nga ky këndvështrim, kjo luhatshmëri nevojitet për të sinjalizuar përdoruesit e valutës mbi rreziqet që shoqërojnë vlerën e ekspozimit të tyre, dhe nevojën për vlerësimin e kujdesshëm dhe ndërmarrjen e veprimeve për zbutjen e këtyre rreziqeve.

### III Konkluzion

Bazuar në ecurinë e viteve të fundit, konstatohet rritje e depozitave në valutë. Niveli aktual i raportit të depozitave në valutë të sektorit privat, ndaj totalit të depozitave pranë sektorit bankar, prej rreth 53%, është dukshëm më lart se niveli mesatar i këtij raporti për vende me ekonomi të ngjashme si Shqipëria. Nga ana tjetër, portofoli i kredive për sektorin privat ka njohur rënie të peshës së kredive në valutë. Megjithëse në rënie, kreditë e pambrojtura ndaj kursit të këmbimit vijojnë të përbëjnë peshë të konsiderueshme të portofolit të kredive për sektorin privat. Borxhi publik ka ardhur në rritje gjatë viteve të fundit, ku kontributin kryesor e ka dhënë rritja e borxhit në valutë, siguruar kryesisht nga subjekte jorezidente. Kursi i këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore ka qenë i qëndrueshëm, madje është forcuar lehtësisht. Ecuria e këtyre treguesve reflekton faktorë ciklikë si edhe dinamikën e ndërveprimit mes tyre.

Mbështetur në këto të dhëna, mund të thuhet se sistemi financiar shqiptar paraqet nivele të larta të euroizimit, që reflektojnë përdorimin e valutës në shkallë të gjerë në ekonominë shqiptare. Në këto kushte, marrja e masave për të kontrolluar dhe ulur këto nivele, në mënyrë graduale është e nevojshme. Banka e Shqipërisë miratoi së fundi disa masa që adresojnë detyrimet dhe aktivet e sektorit bankar. Mbështetur në Memorandumin përkatës të Bashkëpunimit, është e pritshme që edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të identifikojnë masa të ngjashme për tregjet dhe instrumentet që mbikëqyrin. Nëpërmjet këtij raporti do të ndiqet ecuria e treguesve për të vlerësuar ndikimin e masave të ndërmarra dhe nevojën për plotësimin e tyre në të ardhmen.

## Aneks: Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit

Nr.	Masa	Data e adoptimit/e zbatimit	Përshkrim
1	Kufizimi i huave në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.62, datë 14.09.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, neni 15	Huatë në valutë, të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra ku të ardhurat e huamarrësit janë në Lek) nuk duhet të kapërcejnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel, zbritet nga vlera e kapitalit rregullator.
2	Kërkesa minimale për aktive likuide në valutë	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.75, datë 26.10.2011, dhe nr.28, datë 27.03.2013.	Vendosja e një kërkesë minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për Lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan), dhe në total në nivelin 20%.
3	Kërkesa më e lartë për kapital, lidhur me huatë në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.48, datë 31.07.2013 “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.	Huatë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ponderohen me koeficient më të lartë rreziku (150%) për qëllime të llogaritjes së treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.